

VENDIM
Nr. 344, datë 23.9.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRES SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-ja nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 21.10.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Durrës (UK Durrës), me shkresën nr. 3127/2 prot. ERRU, datë 18.8.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Durrës në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Durrës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 355,298 banorë të Bashkisë Durrës, Shijak dhe njësitë administrative Bubq (Bashkia Krujë), Thumanë (Bashkia Krujë), Fushë-Kuqe (Bashkia Kurbin), Prezë (Bashkia Vorë), si dhe përpunimin e ujërave të ndotura në ITUN Durrës me një kapacitet për rreth 250,000 banorë të qytetit të Durrësit, zonës së plazhit dhe fshatrat përreth tij;

b) drejtuesi teknik, z. Gerald Dautaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Hidroteknikë”, në vitin 2013 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion;

c) drejtuesi teknik z. Lorenc Facja është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Hidroteknikë”, në vitin 2012 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Durrës, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të

mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Durrës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a., me (NUIS J61819502V), në kategoritë:

- a) kategoria A – “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) kategoria C – “Për largimin e ujërave të ndotura;
- c) kategoria D – “Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

- a) drejtues ligjor – Spartak Kovaçi;
- b) drejtues teknik – Gerald Dautaj;
- c) drejtues teknik – Lorenc Facja.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a., është:

Bashkia: Durrës, Shijak
Njësia Administrative: Bubq, Thumanë (Bashkia Krujë)
Fushë-Kuqe (Bashkia Kurbin)
Prezë (Bashkia Vorë)

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani